

Gati Spitali i ri i Laçit, model për spitalet e tjera bashkiake



Ka përfunduar investimi për ndërtimin e Spitalit të ri të Laçit. Spitali i rindërtuar pas dëmtimeve nga tërmeti, pritet që të fillojë punën së shpejti. Kapacitetet e këtij spitali janë deri në 40 shtretër. Godina 50 vjeçare ku ushtronte aktivitetin Spitali i Laçit u shpall e pabanueshme pas dëmtimit nga tërmeti i 26 nëntorit 2019. Rindërtimi i këtij spitali ka një vlerë totale investimi 2.8 milionë euro dhe një sipërfaqe ndërtimi prej 2516 m². Me ndërtimin e spitalit të ri, më shumë se 46 mijë qytetarë të zonës së Kurbinit do të përfitojnë shërbim shëndetësor sipas standardeve më të mira.



Mbi 40 mijë shërbime u ofruan falas, në kohë dhe me cilësi për pushuesit dhe turistët në 29 qendrat shëndetësore verore.



40 QENDRA TË REJA SHËNDETËSORE REHABILITOHEN KËTË VIT

Qendra Shëndetësore Orikum do të rehabilitohet në kuadër të programit të 300 qendrave shëndetësore, i cili vijon këtë vit edhe me 40 qendra të tjera, nga veriu në jug. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu vizitoi qendrën shëndetësore të Orikumit, ku tha se kalohet tashmë në një fazë të re, për të siguruar infrastrukturën e të gjithë qendrave shëndetësore në vend, sipas standardeve më të mira.



"FËMIJË NË PËRKUJDESJE TË REPUBLIKËS"

Në fazën e dytë të shqyrtimit të dosjeve, është dhënë Statusi "Fëmijë në Përkujdesje të Republikës" për bijtë e Dëshmorit të Atdheut, Major Klodian Tanushi dhe Dr. Leonard Kamberi. Deri tani janë 15 fëmijë që e kanë përfituar këtë status, duke përfituar deri në 150% të pagës së prindit si dhe paketën e plotë të mbështetjes nga shteti.

FUQIZOHET RRJETI I PAJISJEVETË REJA RADIOLOGJIKE NË SPITALE E POLIKLINIKA

Në kuadër të planit të përballimit të Covid19 dhe emergjencave shëndetësore, po kryhen investime në spitalet universitare, rajonale dhe bashkiake për pajisjen dhe rinovimin e flotës së aparaturave biomjekësore të teknologjisë së lartë, me vlerë 4.2 mln euro. Janë 18 grafi, 4 eko; 4 skanera, të cilët do të fuqizojnë akoma më shumë shërbimin e imazherisë në spitalet dhe poliklinika dhe një angiograf, i cili pritet të instalohej në Spitalin e ri të Sëmundjeve të Brendshme në QSUT.

